

**Autorët për Shqipërinë:**

Alesia GEGUSHI - Monitoruese, Lëvizja MJAFT!

Xheni LAME - Asistent Koordinatore e Programit ActionSEE, Lëvizja MJAFT!

# QEVERISJA E HAPUR E PARLAMENTIT NË RAJON DHE NË SHQIPËRI

## PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES AKTUALE



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Opinonet, gjetjet dhe rekomandimet janë të autor-it/ve dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve.

**Autorët për Shqipërinë:**

Alesia GEGUSHI - Monitoruese, Lëvizja MJAFT!  
Xheni LAME - Asistent Koorditore e Programit ActionSEE, Lëvizja MJAFT!

# **QEVERISJA E HAPUR E PARLAMENTIT NË RAJON DHE NË SHQIPËRI**

**KY PROJEKT ËSHTË MBËSHTETUR FINANCIARISHT NGA BASHKIMI EUROPIAN.  
OPINIONET, GJETJET DHE REKOMANDIMET JANË TË AUTOR-IT/VE DHE NUK PËRBËJNË  
DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E DONATORËVE.**

**KORRIK 2018**

## HYRJE

Në bashkëpunim me partnerët nga rrjeti rajonal i organizatave të shoqërisë civile "Action SEE", Lëvizja MJAFT! përgatiti dokumentin përmes të cilit analizohet niveli i transparencës, hapjes dhe llogaridhënies së Pushtetit Legjislativ në Rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Punimi paraqet rezultate të një kërkimi gjithëpërfshirës, bazuar në metodologji shkencore, kryer nga anëtarë të rrjetit të ActionSEE përgjatë periudhës dhjetor 2017 - shkurt 2018. Qëllimi i këtij kërkimi është të japë një përshkrim të përgjithshëm të situatës në këtë fushë, për të kontribuar në cilësinë e reformave në punën e administratës publike, duke ndikuar në përmirësimin e mirëqeverisjes dhe ndihmuar institucionet për të rritur eficientësinë në punën e tyre. Gjithashtu, synimi ynë është të përmirësohet respektimi i parimeve të qeverisjes së mirë, në të cilën hapja institucionale zë një hapësirë të rëndësishme. Propozimi për politika praktike, shoqëruar me analiza, është i dyti dokument i llojit të tij. Bazuar në kërkimin e zhvilluar, edhe vitin e shkuar, anëtarët e rrjetit hartuan rekomandime për përmirësimin e hapjen institucionale.

Në vijim të rezultateve të kërkimit të zhvilluar në vitin 2016, janë hartuar punime për të përshkruar situatën e institucioneve në Shqipëri dhe në rajon, duke përfshirë mangësitë e identifikuara dhe praktikat më të mira në këtë fushë. Bazuar në këto analiza, rekomandimet e vitit të shkuar u sollën në formën e udhëzuesve për përmirësimin e fushave specifike të mbuluara nga ky kërkim.

Nisur nga gjetjet dhe rezultatet e vitit të shkuar, anëtarët e rrjetit ActionSEE rishikuan metodologjinë e kërkimit duke i përmirësuar dhe përshtatur treguesit e përdorur për studimin, me synimin që informacioni i mbledhur të jetë më cilësor dhe rezultativ nga projekti. Arsyeja e përdorimit të këtyre treguesve më të avancuar është të japin një kontribut më eficient në përmirësimin e hapjes institucionale në rajon.

Mbështetur në njohuritë, rezultatet konkrete dhe analizat e hapjes institucionale rajonale, me besimin se parlamentet janë udhëhequr nga hapa të arritshëm dhe të thjeshtë me synim përmirësimin e situatës në këtë fushë, ndihmuar edhe nga puna e rrjetit të ActionSEE në këtë kuadër, partnerët vendosën të advokojnë në një nivel më të lartë për hapjen institucionale në rajon. Kërkimi i këtij viti u pasurua me tregues, të cilët kërkonin një standard më të lartë të transparencës proaktive.

Politika e hapjes institucionale duhet të jetë një politikë që ndiqet nga të gjithë parlamentet rajonale; duhet të përcaktohet si çdo politikë tjetër e rëndësishme dhe nuk duhet të shihet vetëm si rezultat i një vendimin apo gjendjeje momentale të autoriteteve publike. Çdo shtet i rajonit ka specifikat e veta, kushtet politike në të cilat zhvillon politikën e hapjes institucionale, por ekzistojnë hapësira për veprim të përbashkët rajonal në përmirësim të kësaj situate.

## HAPJA E PUSHTETIT LEGJISLATIV NË RAJON

Bazuar në gamën e gjerë të të dhënave të analizura, ngjashmëri dhe dallime janë vënë re ndërmjet shteteve të rajonit për sa i takon situatës së hapjes institucionale.

Rezultatet e kërkimit të zhvilluar tregojnë se nivelet e hapjes institucionale në rajon nuk paraqiten të kënaqshme. Ashtu sikurse me autoritetet ekzekutive, rezultati i përgjithshëm në nivel rajonal ka qenë më i ulët në krahasim me vëzhgimin dhe matjet e ciklit të mëparshëm të studimit të hapjes institucionale. Në vend të një progresi të pritshëm në sferën e hapjes institucionale, parlamentet në rajon kanë arritur një rezultat më të ulët në krahasim me periudhën e kërkimit të mëparshëm.

Mesatarisht, 61% e treguesve janë plotësuar gjatë vitit 2017 në fushën e hapjes institucionale. Ky rezultat është 2% më i ulët krahasuar me hapjen institucionale të shënuar në vitin 2016, me 63%.

Vlen për t'u theksuar se studimi i këtij viti ishte më gjithëpërfshirës dhe me nivele më të larta advokuese krahasimisht me vitin e shkuar, si rezultat i treguesve të rinj me të cilët hapja institucionale u mat, duke shtrënguar kështu kriteret e matjes. Kjo qasje shtrënguese mbi çështjet e hapjes institucionale mund të ketë qenë një faktor ndikues në uljen e nivelit të hapjes institucionale të pushtetit legjislativ në rajon. Nga ana tjetër, rezultatet dhe të dhënat e analizuara tregojnë se ky pushtet nuk ka bërë përpjekje për të zhvilluar një politikë të tillë nga momenti kur publikimi i shkuar mbi legjislativin është prezantuar, ndaj treguesit e rinj nuk kanë patur një ndikim shumë të rëndësishëm në rënien e përgjithshme të performancës.

Strukturat më të larta legjislative në rajon nuk kanë një strategji të parashikuar për hapjen institucionale siç ishte paraqitur në analizat e hapjes parlamentare në vitin 2016, dhe po kështu mbeti edhe në rezultatet e studimit të kryer në vitin 2017. Kërkesat për hapje institucionale mund të derivojnë vetëm nga Kushtetuta, Rregulloret e Procedurave dhe akteve të tjera ligjore, dhe si të tilla, mund të jenë subjekte të interpretimeve të ndryshme të maxhorancave parlamentare.

Me përjashtim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili arriti një rezultat më të mirë në këtë studim me 75% krahasuar me vitin 2016 (60%), rënia e nivelit të hapjes institucionale në të gjithë parlamentet në nivel rajonal tregon se për një vit ata nuk kanë punuar për të mbajtur shkallën e arritur të kësaj politike, apo të kenë investuar në zhvillimin e saj.

Informacioni mbi punën e parlamentit i përket qytetarëve dhe është e nevojshme që përmirësime të vazhdueshme të bëhen mbi nivelin e kulturës së hapjes parlamentare. Politika e hapjes institucionale duhet të përmirësohet duke ndjekur ritmet e zhvillimeve të reja teknologjike. Këto të fundit, duhet të përdoren në maksimum, ku ndër të tjera duhet të mbështesin dhe të lehtësojnë publikimin e të dhënave elektronikisht. Në mbështetje të kësaj, një karakteristikë e parlamenteve të rajonit është edhe mungesa e përkushtimit për të publikuar të dhëna në format open data, duke minimizuar dhe hedhur poshtë vlerën e përdorimit të informacionit të publikuar.

Mungesa e vullnetit për të punuar mbi përmirësimin e hapjes dhe transparencës parlamentare konfirmohet edhe nga fakti se në vitin 2017, gjysma e numrit të parlamenteve, pjesë e këtij studimi, kanë kthyer përgjigje ndaj pyetësorit të dërguar, një pjesë kyçe dhe e rëndësishme e këtij studimi. Ngurrimi për t'i kthyer përgjigje pyetësorit, në vetvete, është një tregues i mungesës apo pamjaftueshmërisë së interesit për promovimin e hapjes institucionale. Vëzhgimi ynë ka treguar disa pika kritike, pengesa kyçe në zhvillimin e hapjes parlamentare në rajon.

## Transparenca, aksesueshmëria dhe komunikimi me qytetarët

Rënies së vërejtur në transparencën dhe aksesueshmërinë parlamentare në rajon duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë, në mënyrë që këto institucione, të zgjedhura prej qytetarëve dhe për qytetarët, të mund të veprojnë si shtylla kryesore të demokracisë në shoqëritë e këtyre shteteve.

Edhe pse ekzistenca e Ligjit për të Drejtën e Informimit në rajon ka kontribuar në rritje të nivelit të transparencës parlamentare, përforcimi i aplikimit të tij në të ardhmen është një domosdoshmëri; është thelbësore që institucionet e legjislativit të bëjnë përpjekje në përmirësimin e proaktivitetit të tyre në publikimin e informacioneve të fushës së tyre të veprimit.

Edhe pse ndërmjet parlamenteve në rajon ka shembuj të praktikave të mira kur bëhet fjalë për publikimin e të dhënave të punës parlamentare dhe deputetëve, konkludojmë se kuadri ligjor dhe angazhimi për të respektuar parimet e hapjes institucionale dhe standardet ndërkombëtare mbeten vetëm të shkruara në letër. Studimi i këtij viti ka treguar, gjithashtu, se informacioni mbi aktivitetin e deputetëve në komisione, dokumentet që burojnë nga puna në komisione apo amendamentet e dërguara nuk janë ende të publikuara në shumicën e faqeve të parlamenteve në rajon. Për më tepër, publikimi i informacionit mbi punën e parlamenteve dhe të deputetëve rrallëherë është i shoqëruar me llogaridhënien e tyre për rezultatet e arritura dhe cilësinë e punës së këtij institucioni. Rezultati mesatar i arritur nga parlamentet në rajon, në fushën e komunikimit me qytetarët, e cila shënon 35% të plotësisimit të treguesve, është një tjetër çështje shqetësuese.

Parlamentet në rajon vazhdojnë të paraqiten si struktura të ngurta dhe nuk përpiqen të investojnë në kanale të reja komunikimi, të cilat do të ndihmonin në zvogëlimin e boshllëqeve ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre. Një tjetër problem rajonal është edhe respektimi i parimit të publikimit të të dhënave në format open data, e cila do të rriste aksesueshmërinë dhe do ta bënte më të lehtë për qytetarët mbledhjen e informacionit.

Ajo që ngre më shumë shqetësime lidhet me faktin se transparenca dhe komunikimi me qytetarët janë në nivele shumë të ulëta kur bëhet fjalë për përgatitjen, diskutimin, përshtatjen dhe prezantimin (në open data format) e aktit më të rëndësishëm ligjor të vitit, në çdo vend - buxheti i shtetit. Rezultati mesatar për çdo shtet në vitin 2017, në fushën e buxhetit të shtetit është 41%, ku përveç Shqipërisë (86%) dhe Malit të Zi (58%), përqindjet e shteteve të tjera variojnë nga 19% (Serbia) në 32% (Kosova).

Parlamentët e rajonit duhet të bëjnë përpjekje për të vlerësuar plotësisht rëndësinë, rolin dhe opinionin e shoqërisë civile në demokraci dhe të përmirësojnë mekanizmat e bashkëveprimit me të. Është vënë re se, pavarësisht mekanizmave ekzistues dhe vendosshmërisë së deklaruar të përfaqësuesve të pushtetit legjislativ, bashkëveprimi parlamentar me shoqërinë civile, në rajon, është përgjithësisht një parim i cënuar.

Republika e Serbisë e ndërpreu bashkëpunimin me Open Parliament, si rrjedhim i protestës që kjo e fundit mbajti për mënyrën sesi u debatua dhe u miratua ligji i buxhetit të vitit 2018.

## **Mbikëqyrja parlamentare - baza të mira, por zbatueshmëri e dobët**

Parlamentet e rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë ngritur baza të mira për mbikëqyrjen parlamentare - përveç rastit të Kosovës që arrin 19% të plotësisht të treguesve. Megjithatë, është e rëndësishme që këtij funksioni të pushtetit legjislativ t'i kushtohet shumë vëmendje, në nivel rajonal, duke siguruar zbatimin e tij të plotë në praktikë. Pavarësisht një bazë të mirë ligjore mbi ushtrimin e mbikëqyrjes së parlamentit, kjo nuk do të thotë se ky funksion zbatohet plotësisht. Parlamentët në rajon e aplikojnë këtë funksion në mënyrë formale, gjë e cila shkakton rezultate të tilla. Nevoja për të forcuar kontrollin dhe monitorimin e funksionit të parlamentit në termat e zbatimit efektiv është theksuar edhe nga Komisioni Europian në raportet e dedikuara për secilin prej shteteve, publikuar në prill të vitit 2018.

Situata aktuale na nxjerr në të njëjtat konkluzione të kërkimit të vitit të shkuar. Është shumë e rëndësishme që parlamentet të mos jenë ato institucione që miratojnë propozimet e pushtetit ekzekutiv pa u bërë kritika, por të jenë kontrolluese dhe të japin pikëpamjet e tyre për çdo akt ligjor të propozuar. Detyrat legjislativ të deputetëve nuk duhet të jenë një arsye për të neglizhuar funksionin kontrollues, i cili është një nga parimet kryesore të garantimit të demokracisë. Të gjithë parlamentet në rajon duhet të bëjnë përpjekje në zbatimin e plotë të mekanizmave ekzistues, duke kontribuar në rritjen e nivelit të llogaridhënies politike.

### **Vlerësim dhe kontroll i ulët i punës së parlamentëve dhe sjelljes së deputetëve - efektet, integriteti dhe etika.**

Edhe në vitin 2017, puna e parlamentëve në rajon nuk ka qenë e bazuar në përcaktimin e një metode uniform dhe treguesish të përshtatshëm për matjen e rezultateve dhe cilësisë së punës së tyre dhe punës së deputetëve. Planifikimi strategjik i parlamenteve në nivel rajonal arrin vetëm 25% të plotësimin të treguesve, ku parlamenti i Serbisë dhe ai i Kosovës shënuan zero pikë në zbatimin e këtij treguesi. Kjo situatë, e cila përsëritet çdo vit, vazhdon të ketë një ndikim në cilësinë e punës parlamentare dhe në informimin qytetar mbi efektet dhe rezultatet e punës së pushtetit legjislativ.

Në shumë parlamente në rajon, ligji i lobingut nuk është miratuar ende. Për më tepër, parimi i integritetit në pushtetin legjislativ mbetet në nivele të ulëta, si pasojë e mosmiratimit të Kodit të Etikës në parlamentet e disa vendeve të rajonit, ose nuk zbatohen siç duhet. Ashtu si në vitin 2016, edhe në matjet e këtij cikli, etika e punës parlamentare dhe e deputetëve ka shënuar vlera të ulëta dhe rekomandimet e bëra nuk janë marrë parasysh.

Është e rëndësishme që parlamentet të cilët nuk e kanë miratuar ende Kodin e Etikës, ta vendosin këtë çështje si prioritet në agjendat e tyre. Për më tepër, parlamentet e shteteve të rajonit duhet të vendosin mekanizma të qartë për monitorimin e zbatimit të Kodit të Etikës së deputetëve dhe sanksione për çdo cënim të standardeve. Praktikrat nga rajoni tregojnë se cënimi i Kodit të Etikës nuk rezulton përgjithësisht në



sanksionim të sjelljes jokorrekte, dhe shpesh përfaqëson subjektin e marrëveshjeve politike. Aplikimi i Kodit të Etikës është i rëndësishëm për rritjen e nivelit të llogaridhënies politike dhe besimit publik në punën e parlamentit.

## HAPJA E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bazuar në matjet e kryera, Kuvendi i Shqipërisë ka rezultuar 75% institucionalisht i hapur. Ky vlerësim paraqitet pozitiv, si i krahasuar me mesataren e performancës së rajonit për këtë pushtet, ashtu edhe në krahasim me pushtetet e tjera në vendin tonë, ku Kuvendi vazhdon të mbetet institucioni më i hapur ndaj publikut të gjerë. Edhe pse ky institucion shfaqet si përfaqësues i disa prej praktikave më të mira të aksesueshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit, sigurisht që mbetet ende punë për t'u bërë e për t'u përmirësuar institucionalisht.

Performanca sipas katër shtyllave të mirëqeverisjes për Kuvendin është: 88% plotësimin e treguesve të aksesueshmërisë, 84% të treguesve të efektshmërisë, 71% transparencë dhe 60% treguesit e integritetit.

Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë përditësohet çdo ditë me informacione që lidhen me aktivitetin administrativ ose jo të këtij institucioni. Lista e projektakteve, aktet ligjore të miratuara, procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve dhe të seancave plenare, kalendaret e punës dhe rendet ditore të veprimtarisë së komisioneve parlamentare, prezenca e deputetëve dhe mënyra si kanë votuar projektaktet mund të gjenden lehtësisht në faqe. Megjithatë, ka ende çështje të cilat nuk janë në përputhje me standardet e rekomanduara ndërkombëtare për hapjen institucionale.

## **Përmirësime në Kodin e Etikës së Kuvendit dhe rregullimi i parandalimit të konfliktit të interesit.**

Gjatë realizimit të këtyre matjeve, Kodi i Sjelljes së Deputetëve ka qenë në proces diskutimi në komisionet parlamentare. Për të arritur deri në miratimin e tij, është kërkuar një periudhë e gjatë kohe për ta hartuar. Ligji është miratuar në prill të këtij viti, por ende nuk ka filluar zbatueshmërinë e tij, në pritje të akteve normative. Gjithashtu, lobistët dhe aktivitetet e tyre vazhdojnë të mbeten të pa rregulluara me ligj në Shqipëri, ku ende nuk është krijuar medium për hartimin e një projektligji të tillë.

Edhe pse deklarimi i pasurive të deputetëve përfshin informacion mbi burimin e të ardhurave, të ardhurat nga puna jashtë Kuvendit dhe dhuratat, edhe pse mosdeklarimi në kohë i pasurisë pasohet nga sanksione administrative, këto tabela mund të bëhen publike vetëm përkundrejt një kërkesë ndaj Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Procedura e deklarimit të pasurive ende nuk ka filluar të realizohet në mënyrë elektronike.

## **Përmirësim i komponentit të transparencës institucionale. Më shumë informacion mbi prokurimet publike**

Në faqen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nuk janë të publikuara programet vjetore të punës, edhe pse mund të aksesohen raportet mbi punën e realizuar përgjatë vitit. Duke iu referuar veprimtarisë voluminoze që institucioni kryen përgjatë vitit dhe rëndësisë së llogaridhënies së vazhdueshme ndaj publikut të gjerë si institucioni më i lartë i ligjbërjes së shtetit, raportet e ndërmjetme mbi rezultatet e arritura shfaqen si një domosdoshmëri për të vëzhguar ecurinë e veprimtarisë administrative dhe ligjore. Po ashtu, këto raporte nuk janë publikuar në faqe. Megjithatë, për publikun e gjerë apo për organizatat të cilat veprimtarinë e tyre e lidhin me atë të Kuvendit, bëhet i vështirë monitorimi i ecurisë së institucionit, pasi mungesa e raporteve për parashikime vjetore nuk lë mundësi për të matur nivelin e realizueshmërisë së planeve në momente të ndryshme të vitit.

Për sa i takon burimeve njerëzore të administratës së Kuvendit, në faqe

është publikuar vetëm organigrama sipas departamenteve dhe niveleve hierarkike, pa i dhënë një hapësirë emrave, pozicioneve, kontakteve dhe pagave (apo nivelit të pagës) të nëpunësve civilë të emëruar në këtë institucion.

Lidhur me seancat plenare, mënyra e votimit të deputetëve, për secilin prej projektakteve në rendet e ditës, është e publikuar në faqe. Gjithashtu, transmetimi live nga Televizioni Shqiptar i të gjithë seancave plenare përfaqëson një praktikë të mirë transparence të Kuvendit të Shqipërisë. Por kjo praktikë nuk ndiqet edhe në rastet e mbledhjeve të komisioneve parlamentare. Transmetimi i tyre vjen në trajtën e kronikave nga mediat private dhe mënyra sesi deputetët e pranishëm votojnë projektligjet që diskutohen në rend dite, nuk bëhet transparente.

Procesverbalet e diskutimeve të të pranishmëve postohen në faqen e Kuvendit, por është vënë re se publikimi i këtyre procesverbaleve bëhet disa javë pas zhvillimit të mbledhjeve apo seancave parlamentare. Transparenca kërkon që institucionet të bëjnë publike të dhëna dhe informacione në mënyrë të detajuar dhe të kuptueshme për publikun.

Kur të dhënat mbi veprimtarinë e përditshme administrative mungojnë, ekziston një lidhje e drejtë interpretimi për praktika korruptive në nivel institucional dhe shmangie e opinionit të gjerë publik. Qeveritë, të cilat operojnë në mënyrë më efektive, kanë trende më pozitive në nivelet e transparencës institucionale. Transparenca i lejon qytetarët të vlerësojnë dhe të imponojnë politikat publike (Kopits G. & Craig J., 1998)<sup>1</sup>. Transparenca buxhetore paraqet një çështje që duhet trajtuar për këtë institucion. Planet, thirrjet, vendimet, kontratat dhe shtojcat e procedurave të Prokurimeve Publike që kryen Kuvendi i Shqipërisë nuk janë transparente në faqen zyrtare. Gjithashtu, buxheti i qytetarëve nuk është një praktikë që ndiqet nga organi më i lartë ligjvënës në Shqipëri. Administratat, të cilat janë të orientuara drejt qytetarëve, për të maksimizuar kënaqësinë e tyre dhe rritur fokusin ndaj tyre duke ju ofruar shërbime me më shumë cilësi, qartësi dhe transparencë, janë të prirura të zhvillojnë buxhetim qytetar dhe sistem buxheti qytetar, duke i përfshirë qytetarët në faza të ndryshme të buxhetimit. Qëllimi i këtij buxhetimi është të thjeshtëzojnë mënyrën e publikimit të buxhetit publik dhe ta bëjë atë më të kuptueshëm nga qytetarët (Bilge S., 2015)<sup>2</sup>.

1) Kopits G. & Craig J., January 1998, Transparency in Government Operations. International Monetary Fund, Washington DC

2) Bilge S., Spring 2015, A new approach in Public Budgeting: Citizens' Budget, Eskiehir Osmangazi University

3) Neni 24, Ligji Nr.  
119/2014, datë 18.09.2014  
“Për të drejtën e informimit”

## **Nivelet e aksesueshmërisë së qytetarëve ndaj Kuvendit të Shqipërisë duhet përmirësuar, gjithashtu. Hartimi i udhëzuesve dhe zhvillimi i trajnimeve për të ofruar të dhëna të hapura dhe të ripërpunueshme mbetet ende një çështje.**

Edhe pse ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” paraqitet si një nga ligjet më të mira në Europë në fushën e aksesimit të informacionit zyrtar, vlen të theksohet se administrata publike ende nuk shfaq rezultate mjaft të kënaqshme në zbatimin e neneve të këtij ligji. Ligji nuk parashikon detyrim për zhvillimin e trajnimeve për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore që e ushtrojnë këtë funksion brenda institucioneve publike. Trajnimet për të drejtën e informimit zhvillohen në vullnetin e institucionit të pavarur të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Performanca e ulët e publikimit të të dhënave të hapura dhe të ripërpunueshme, prej rreth 33% aksesueshmëri për administratën e Kuvendit, thekson nevojshmërinë e trajnimeve më të shumta në këtë fushë. Konkretisht, administrata e Kuvendit është shprehur se ka marrë pjesë në një trajnim në lidhje me open data format, por nuk ka dhënë informacion mbi datën e zhvillimit të këtij trajnimi.

Mungesa e udhëzuesve përbën një pengesë për sigurimin e ndërveprimit qytetar me qeverinë në tërësi. Edhe pse ligji për të drejtën e informimit parashikon të drejtën e ankimit në rastet kur nuk merr përgjigje nga institucionet për kërkesat e dërguara për informacion zyrtar <sup>3</sup>, nuk ka një rregullim ligjor apo udhëzues që të qartësojë qytetarët mbi mënyrat sesi të ngrenë shqetësime, të apelojnë apo të zhvillojnë peticione online mbi nisma ligjore që prekin interesin e përgjithshëm publik.

## **Metodologjia e kërkimit**

Qeverisja e hapur përfaqëson një kusht kyç të demokracisë pasi kjo u lejon qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendim-marrje efektive dhe pasjen e institucioneve të përgjegjshme për politikën që ato ndjekin.

Ndërkombëtarisht, institucionet ndërmarrin aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e transparencës së tyre dhe llogaridhënies te qytetarët.

Indeksi Rajonal për Qeverisjes e Hapur të pushtetit ekzekutiv është ndërtuar me qëllim përcaktimin se në cilën shkallë qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin dhe kuptojnë informacionin e publikuar nga institucionet publike të tyre.

Indeksi Rajonal i Qeverisjes së hapur mat shkallën në të cilën institucionet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, dhe ai bazohet në katër parimet bazë si vijon: 1) Transparenca 2) Aksesueshmëria 3) Integriteti dhe 4) Efektshmëria

Parimi i transparencës përfshin informacionin organizativ, buxhetin dhe procedurat e prokurimeve publike të cilat janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara. Aksesueshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për akses të lirë në informacion, duke përmirësuar disponueshmërinë e informacionit përmes mekanizmave të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. Integriteti përbëhet nga mekanizmi i parandalimit të korrupsionit, mbajtjen e kodit etik dhe rregulloret e lobimit. Parimi i fundit, Efektshmëria i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet sikurse dhe shembuj të praktikave të mira, këto parime janë zhvilluar më tej përmes treguesve specifik cilësorë dhe sasiorë, të cilët janë vlerësuar në bazat: e aksesueshmërisë së informacionit në websitet zyrtare të institucioneve, shqyrtimit të kuadrit ligjor për çështje të veçanta, e burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione.

Përmes rreth 110 treguesve, kemi matur dhe analizuar hapjen institucionale të pushtetit legjislativ dhe janë mbledhur më shumë se 1,000 të dhëna. Mbledhja e të dhënave është pasuar nga procesi i verifikimit, ku rezultoi një devijim standard prej +/-3%. Matjet janë kryer gjatë periudhës dhjetor 2017 deri në fund të shkurt 2018.